



Republika e Kosovës / Republika Kosovo / Republic of Kosovo Autoriteti i Aviacionit Civil i Kosovës Autoritet Civilnog Vazduhoplovstva Kosova Civil Aviation Authority of Kosovo		
Nr. i prot. / Br. prot./Prot.Nr.	2024/20P/42	
Faqe: / Stranica/Pages	3	Kopje: / Kopije/Copy
Hyrës/ulazno/in		<input type="checkbox"/>
Dalës/izlazo/out		<input checked="" type="checkbox"/>
Brendshëm/nterno/internal		<input type="checkbox"/>
		Prishtinë/Prishtina/Pristina

02/ZDP/VE/2024
Datë: 30 janar 2024

Në mbështetje të neneve 2, 14.2, 35, 36 të Ligjit nr. 03/L-051 për Aviacionin Civil, i ndryshuar me Ligjin Nr.08/L-063 për ndryshimin dhe plotësimin e ligjeve që kanë të bëjnë me racionalizimin dhe vendosjen e vijave llogaridhënëse të Agjencive të Pavarura, nenit 24 të Ligjit Nr. 06/L-113 për Organizmin dhe Funksinin e Administratës Shtetërore dhe Agjencive të Pavarura, nenit 53 të Ligjit Nr. 05/L-031 për procedurën e përgjithshme administrative, Marrëveshjes për Shërbime të Rregullta Ajrore ndërmjet Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Këshillit Federal të Zvicrës, të datës 30 Nëntor 2010 dhe Memorandunit të Mirëkuptimit për marrëveshje për shërbime ajrore të datës 29 Prill 2009 në mes të Autoriteteve të Aviacionit Civil të Republikës së Kosovës dhe Këshillit Federal të Zvicrës,

Duke vepruar sipas pikës 2 të Vendimit me nr. Ref.533/18, i dt. 20. 06.2018, rreth mundësisë së revokimit të autorizimit të lëshuar për Kompaninë Eurowings GmbH,

Drejtori i Përgjithshëm i Autoritetit të Aviacionit Civil (më tutje "AAC") nxjerr këtë:

VENDIM

1. REVOKOHET autorizimi i lëshuar përmes Vendimit nr. Ref.533/18, të Ministrisë përgjegjëse për transport, për Kompaninë Eurowings GmbH, me COA nr. D-003 (siç është ndryshuar EASA.AOC.005 dhe EASA.AOC.006), që në bashkëpunim me agjentin e autorizuar Kosova Airlines (të regjistruar me nr. biznesi 8025352) të ushtrjnë të drejtat e pakufizuara të trafikut ajror për në, dhe nga Zvicra.
2. Revokimi i autorizimit nga pika 1 e këtij Vendimi nuk vlen për Sezonin Dimëror 2023/2024.
3. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

Arsyetim

Me ndryshimin e Ligjit Nr. 03/L-051 për Aviacionin Civil, përmes Ligjit Nr.08/L-063 për ndryshimin dhe plotësimin e ligjeve që kanë të bëjnë me racionalizimin dhe vendosjen e vijave llogaridhënëse të Agjencive të Pavarura, Autoritetit të Aviacionit Civil të Kosovës i janë dhënë

përgjegjësitë për rregullimin e veprimtarisë së transportuesit ajror, në linjat e përcaktuara në përputhje me marrëveshje dypalëshe ose shumëpalëshe.


Me dt. 20.06.2018 përmes Vendimit me nr. Ref.533/18, Ministria përgjegjëse për transport, i ka lëshuar autorizimin Kompanisë Eurowings GmbH, me COA nr. D-003 003, me seli në Von-Gablenz -str.206, 5069 Koln të Gjermanisë, (siç është ndryshuar EASA.AOC.005 dhe EASA.AOC.006), me që në bashkëpunim me agjentin e autorizuar Kosova Airlines (të regjistruar me nr. biznesi 8025352), të ushtror të drejtat e pakufizuara të trafikut ajror për në, dhe nga Zvicra, në pajtim me nenin 3 të Marrëveshjes për Shërbime Ajrore në mes të Republikës së Kosovës dhe Këshillit Federal të Zvicrës, dhe në pajtim me Memorandumin për Shërbime të Trafikut të Rregullt Ajror. Autorizimi i dhënë përmes Vendimit me nr. Ref.533/18, nuk parasheh asnjë kusht për mënyrën e shfrytëzimit të këtyre të drejtave, të dhëna përmes Vendimit në fjalë.

Përderisa në bazë të Vendimit nr. 533/18 të dt.20.06.2018 është pritur që nga shërbimet ajrore të ofruara nga kompania Eurowings GmbH midis Kosovës dhe Zvicrës të përfitojë publiku dhe të ketë efekt në zhvillimin e aviacionit civil, të dhënat statistikore të trafikut ajror tregojnë se në periudhën 2019-2023 pjesëmarrja e Eurowings GmbH në trafikun e gjithmbarshëm midis Kosovës e Zvicrës ka qenë 2%.

Duke marrë parasysh interesin publik të vendit, faktin që Republika e Kosovës nuk ka kompani ajrore shtetërore e cila do të autorizohet për të ushtruar të drejtat e trafikut ajror në bazë të marrëveshjeve bilaterale të transportit ajror, në anën tjetër Kompania Eurowings GmbH nuk ka ndonjë kusht që përcakton mënyrën se si duhet të shfrytëzohet e drejta e marrë përmes Vendimit nr. Ref.533/18, AAC në përputhje me kompetencat që ka sipas Ligjit Nr. 03/L-051, me ndryshime, ka vendosur të revokoj autorizimin e lëshuar përmes këtij Vendimi.

AAC së shpejti do të publikoj shprehjen e interesit për marrjen e të drejtave të trafikut ajror në emër të Kosovës, për në dhe nga Zvicra (designation), ku do të përcaktohen dhe publikohen kushte në bazë të të cilave kompanitë ajrore do të mund të shfrytëzojnë autorizimin për ushtrimin e të drejtave të trafikut ajror në emër të Kosovës, për në Kosovë dhe nga Zvicra, në pajtim Marrëveshjen për Shërbime Ajrore në mes të Republikës së Kosovës dhe Konfederatës së Zvicrës, dhe në pajtim me Memorandumin për Shërbime të Trafikut të Rregullt Ajror

Duke marrë parasysh nenet 2, 14.2, 35, 36 të Ligjit Nr. 03/L-051 për Aviacionin Civil, i ndryshuar me Ligjin Nr.08/L-063 për ndryshimin dhe plotësimin e ligjeve që kanë të bëjnë me racionalizimin dhe vendosjen e vijave llogaridhënëse të Agjencive të Pavarura, nenin 24 të Ligjit Nr. 06/L-113 për Organizmin dhe Funkcionin e Administratës Shtetërore dhe Agjencive të Pavarura, Nenin 53 të Ligjit Nr. 05/L-031 për procedurën e përgjithshme administrative, Marrëveshjen bilaterale për shërbime për transportin ajror në mes Republikës së Kosovës dhe Konfederatës së Zvicrës, Memorandumin e Mirëkuptimit për marrëveshje për shërbime ajrore, në mes të Autoriteteve të Aviacionit Civil të Republikës së Kosovës dhe Këshillit Federal të



Zvicrës dhe interesin publik, Drejtori i përgjithshëm ka vendosur si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Udhëzim mbi mjetin juridik: Pala e pakënaqur me këtë vendim mund të ushtroj padi për konflikt administrativ pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë, Departamenti për Çështje Administrative, në afat prej 30 ditësh nga dita e pranimit.


Alban Ramabaja
UD. Drejtor i Përgjithshëm



Vendimi i dërgohet:

- Kompanisë Eurowings GmbH;
- Ministrinë e MMPHI; dhe
- Arkivën e AAC-së.